

LINGUISTIC SPECIFICS OF ALBANIAN AND MACEDONIAN PROVERBS ABOUT WOMAN

Valjbona Toska

Faculty of Philology, “Ss. Cyril and Methodius” University, Skopje, Republic of N. Macedonia,
valbona_toska@yahoo.com

Abstract: The linguistic analysis in the Semantic, Pragmatic and Syntactic terms shows that the corpus of proverbs about women in both languages (Albanian and Macedonian) conveys the same type of messages – i.e. messages which in the respective languages are realized with different formal structures, while the number of proverbs is greater in relation to their repeated messages. In addition to the proverbs that carry a pragmatic override and that *explicitly* instruct what should/ should not be acted upon, their semantics reveal that these short sayings also *implicitly* contain instructions. What stands out as congruence with the structure is the realization in almost the same schemas. In syntactic constructions *the parallelism* at different structural levels is presented as a more prominent element - at sentence level, reduced parallelism, and syntagmatic parallelism. In the creation of universality, *genericity* and *timelessness* participate, and the close contact frame is created by the grammatical category of the Mood and the Person.

Keywords: Proverbs, Albanian, Macedonian, semantics, pragmatics, syntax.

SPECIFIKAT GJUHËSORE TË PROVERBAVE SHQIPE DHE MAQEDONASE PËR GRUAN

Valbona Toska

Universiteti „Shën Cirili dhe Metodi”, valbona_toska@yahoo.com

Analiza gjuhësore në rrafshin semantik, pragmatik dhe sintaksor tregon se korpusi i proverbave për gruan në të dy gjuhët (në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase) përcjell një tip të njëjtë të porosive, të cilat në gjuhët përkatëse realizohen me struktura të ndryshme formale dhe se numri i fjalëve të urta është më i madh në raport me mesazhet e tyre të cilat përsëriten. Përkrah proverbave që bartin një mbindërtim pragmatik dhe që udhëzojnë në mënyrë *eksplicite* si duhet/nuk duhet të veprohet, semantika e tyre zbulon se këto thënie të shkurtra edhe në mënyrë *implicit* përmbajnë instruksione. Ajo që veçohet si përputhje në lidhje me strukturën është realizimi në skema pothuaj të njëjta. Në ndërtimet sintaksore si element më i theksuar paraqitet *paralelizmi* që paraqitet në nivel të ndryshëm strukturor – në nivel të fjalisë, paralelizëm i reduktuar dhe paralelizëm në nivel të togfjalëshit. Në krijimin e universalitetit marrin pjesë *përgjithësimi* dhe *gjithëkohësia* kurse kornizën e kontaktit të afërt e krijojnë kategoria gramatikore e mënyrës dhe e vetës.

Fjalë kyçe: Proverba, shqipe, maqedonase, semantikë, pragmatikë, sintaksë.

1. HYRJA

Struktura e tyre që i tkurr në mikro sisteme, funksioni i theksuar komunikativ, si dhe fakti që ato janë të lidhura ngushtë me shprehjet frazeologjike – komponentë të fondit leksikor të një gjuhe, proverbat i shndërron në një platformë të mirë për të zbatuar qasje të caktuar bashkëkohore gjuhësore. Atë që paremiologjia bashkëkohore e veçon në lidhje me proverbat është se ato trajtohen si shenja me një kuptim të caktuar (semantikë), me një raport të caktuar ndaj folësit dhe/ose dëgjuesit (pragmatikë) dhe me një strukturë të caktuar të përgjithshme të thënies (sintaksë). Do të prezantojmë shqyrtime pikërisht nga këto fusha që i veçojnë proverbat në një mikro sistem semiotik dhe gjuhësor, me çka jo vetëm që përcaktohen veçoritë e tyre gjuhësore, por edhe dallohet pozita e tyre në raport me zhanret e tjera letrare.

2. SEMANTIKA DHE PRAGMATIKA

Vëmendja kryesore e pragmatikës si dhe e semantikës është drejtuar nga nocionet vërtetësi e vlefshmëri, të cilat trajtohen edhe në raport me kontekstin e përdorimit. Detyra themelore e semantikës është të shpjegojë në çfarë mënyre disa kuptime të ndryshme lidhen me kategoritë e veçanta morfo-sintaksore dhe si kuptimet e frazave komplekse varen nga kuptimet e komponentëve të tyre. Kurse Çarlls Moris pragmatikën e përkufizon si një disiplinë që në analizën e saj, përkrah shprehjeve gjuhësore dhe objekteve të cilave ato u referohen, i përfshin edhe përdoruesit dhe kontekstet e mundshme të përdorimit. Ajo e përfshin edhe studimin e mjeteve të komunikimit të

ndërlidhura me njeriun: çfarë ndodh me njeriun kur jep dhe merr njoftime; prej se varet forma e komunikimit (në parim dhe konkretisht); në ç'masë forma e komunikimit kushtëzohet nga lloji i kulturës.

Që të arrijmë një formalizim të pjesshëm, me çka do të arrihej edhe një klasifikim që do të mundësojë krahasimin e tyre tipologjik, vendosëm t'i deshifrojmë proverbat shqipe dhe maqedonase për gruan. Parafrazat e nxjerra mbështeten në një, thënë kushtimisht, konventë tradicionale (kohore, hapësinore dhe socio-kulturore). Në fakt, parafrazat janë refleksi i njohurive tona për kuptimin e thellë të proverbave. Sipas traditës, u shërbyem me gjuhën e logjikës, me ç'rast njerëzit i kemi shënuar me x, y, z ; objektet me m, n ; karakteristikat me a, b ; gjendjet dhe situatat me p, q, r . „Opozita” e njohur mes x dhe y , na mundësoi të kundërvëmë gjinitë e kundërta: x gjinia femërore; $y =$ gjinia mashkullore, me ç'rast në varësi nga rolet e ndryshme në të cilat paraqiten, u shtojmë edhe indeks shtesë (p.sh. $x_1 =$ nënë; $x_4 =$ njerë; $y_1 =$ baba etj.).

Duke u mbështetur në parimet shumë të afërta të semantikës dhe pragmatikës në analizën tonë këto qasje përfshihen në një tërësi. Përderisa mesazhin e identifikojmë me semantikën, zbatimin e tij e identifikojmë e pragmatikën meqë impulsi (nxitja) i përdorimit është pragmatik.

Qasja jonë e përgjithshme ndaj proverbave mbështetet në pikëpamjet teorike të A. Boguslawski⁵ dhe tezat që i kemi përkrahur janë:

- Karakteri i përgjithshëm i proverbave qëndron në faktin se ato flasin për nocione; kjo u mundëson të paraqesin tekste të mëvetësishme;
- Proverbat janë tekste që
 - a) ndërtohen nga një fjali,
 - b) riprodhohen me synim të riprodhohet jo vetëm brendia e caktuar, por edhe forma dhe prapëseprapë nuk janë citate të thënies së dikujt,
 - c) mund të interpretohen si tekste të mëvetësishme, mund por nuk është e domosdoshme të futen në kontekst më të gjerë;
- Klasa themelore e proverbave janë proverbat metaforike (proverbat jo metaforike do të kishin mundur t'i quajmë aforizma ose sentenca)
- Proverb metaforik normal është fjali e zakonshme me temë e brendi të organizuara sipas rregullave të përgjithshme të gjuhës së dhënë; nuk ka arsye fjalive të tilla t'u hiqet kuptimi, përkatësisht kuptimi i komponentëve të tyre;
- Relacionet që paraqiten në proverbat metaforike janë relacione ekzistenciale; një pjesë e madhe e tyre janë ekzistenciale mohuese.

Meqenëse njësitë e përdorura në proverba nuk e kanë kuptimin që e kanë në të folurit e zakonshëm, por kuptimi i tyre është figurativ, është e nevojshme: 1) të bëhet analizë semantike - çfarë janë paralelet, nga cilat fusha dalin pamjet prej nga burojnë metaforat, të shihet mënyra se si realizohen, çfarë njohurish ofrojnë ato për mjedisin në të cilin funksionojnë proverbat; dhe 2) të deshifrohen proverbat, si dhe të bëhet analizë semantike e mesazheve të tyre.

Nga pikëpamja pragmatike, te proverbat ka një korrelacion mes formës dhe brendisë – të gjitha proverbat me mbindërtim pragmatik i drejtohen adresatit veta e dytë, në mënyrën urdhërore, por jo të gjitha proverbat me këtë formë i interpretojmë si proverba me mbindërtim pragmatik përkatës:

Gruan dhe kalin zgjidhi vetë

Dije se x duhet të vendosë në mënyrë të pavarur për disa punë

Жена млада и вино старо земај

Dije se duhet të vendosësh ndryshe gjatë zgjedhjes, sepse një veti nuk vlen njëlloj për të gjithë

(proverba me mbindërtim pragmatik, ku forma korrespondon me brendinë)

Siç shihet, si eksponent të komponentit pragmatik të përmbajtur në proverb për parafrazat e kemi zgjedhur shprehjen *dije se*, kurse varësisht nga ajo nëse proverbi bart mesazh pohues ekzistencial apo ka element mohues, i shtojmë edhe eksponentët *duhet* përkatësisht *nuk duhet*.

Sipas kategorive të akteve të të folurit, shembujt e lartpërmendur bëjnë pjesë në të ashtuquajturat thënie *direktive*, sepse në to, qoftë në mënyrë *eksplicite*, qoftë në mënyrë *implicit*, identifikohet instruksioni.

Në kudër të proverbave të tjera, tek ato që bëjnë pjesë në thëniet *asertive*, ku përmbahen informata të caktuara e pohime, dallohen disa kategori thëniesh:

-thënie që japin konstatime ekzistenciale që u referohen gjendjeve dhe njerëzve; këtu përfshihen edhe ato mesazhe që përmbajnë mohim, që në thënie mund edhe të mungojë. Elementi përbashkët i thënieve është eksponenti **është e vërtetë**, përkatësisht **nuk është e vërtetë**:

⁵ A. Boguslawski Pzmiennik Literacki 47/3 1976. f.144-170 O podstawach ogolnej charakerystyki przyslow

Shpia asht e grues
Është e vërtetë se *m* mbështetet në *x*
Gocni – mbretni
Ергенл'к везирл'к
Nuk është e vërtetë se me *y* ke përparësi
Женско кога се раѓа, стреите плачат
Është e vërtetë se kur lind *x*, ka trishtim

-thënie që përmbajnë implikim **në qoftë se** → **atëherë**

Në marrshi kudo, del shkado
Ако е мажот пијаница, жената ќе биде маченица
Në qoftë se p **atëherë q**

3. SINTAKSA

Në përkufizimet e proverbave rregullisht theksohet struktura e tyre karakteristike me tiparet dalluese: të shkurtra, të ngjeshura, të ngjashme me formulat, të cilat mes tjerash i diferencojnë nga realizimet e tjera gjuhësore dhe letrare. Ndërtimi i tyre paraqet një bazë të përshtatshme për të zbatuar interpretime të veçanta bashkëkohore nga fusha të ndryshme të gjuhësisë. Sintaksa tradicionale proverbat i trajton si fjali, zakonisht të përbëra nga dy pjesë (edhe në rastet kur pjesa e dytë mungon, ajo paramendohet logjikisht), në të cilat disi dominon paralelizmi dhe në të cilat artikulohej kategori të caktuara gramatikore, përmes së cilave njihet veçantia e gjuhës së tyre. Sintaksa e orientuar nga semantika duke i tejkuluar karakteristikat formale të një diskursi të dhënë, depërton më shumë në „kuptimet e thella” të cilat na i porosit ky diskurs. Në këtë drejtim i orientuam edhe analizat tona. Atë që e veçojmë si dalluese në raport me sintaksën e ndamë në tri pjesë: *struktura formale*, *kuptimet gramatikore* dhe *natyra e lidhjes*.

Vetë fakti që proverbat radhiten mes formave më të thjeshta ose më të imta, flet se **struktura e tyre formale** është miniaturë. Një strukturë e tillë implikon përdorim të komponentëve përkatës gjuhësorë – fjalë, togfjalësha, shprehje frazeologjike, ndërtime gramatikore dhe semantike. Ajo që bie në sy është fakti se edhe proverbat shqipe edhe ato maqedonase realizohen me skema sintaksore pothuaj të njëjta. Edhe pse përmbajtja e tyre e brendshme nuk është e thënë të korrespondojë me atë që paraqitet në planin formal, pikërisht forma është ajo që e shpreh ndërtimin arkitektonik të proverbave. Në këtë ndërtim si element më i theksuar paraqitet paralelizmi, i cili mund të jetë në nivel të ndryshëm strukturor:

-në nivel të fjalisë

(Mosha do moshën) e (rrushi do koshin)
(Убавите жени оро играат) а (зрдите кука чуваат)

-paralelizëm i reduktuar

(Shtëpia nuk pushon në tokë), por (në grue)
(Мажот гради кука), а (жената дома)

-paralelizëm në nivel të togfjalëshit (që përmban krahasim)

(Martesa e parjekun)-(pendim i gjatë)
(Без жена) (без кука)

Këto paralelizma shpesh janë asindetike, por jo rrallë edhe sindetike. Nga pikëpamja semantike në këto raste flasim për kundërvënie. Prania e lidhëzave është bazë për ndarjen e këtyre kundërvënieve në dy lloje:

-strukturëe.....

Gruja i ka flokët e gata e mend e shkurta
Жената баница сука, а мажот тапан чука

-strukturë (nuk).....po.....

Nuk pëlqeva çerdhen, **po** pëlqeva zogun
He gledaj naдушnata, **ami** na jatkata

Në fondin e analizuar, përkrah fjalive të thjeshta, ka mjaft thënie të përbëra me nga dy, tri e më rrallë edhe më shumë pjesë:

-fjali të thjeshta

Vajza e bukur len e martuete
Жена вера нема

-ndërtime me dy pjesë (sifjali)

(Çikën niqin vetë e lypin) e (njani e merr)
(Ако имаи лична жена) (не оди на тугина)

-ndërtime me tri pjesë

(Ç'e do mallnë) e (ç'e do gjënë), (kur s'ke gruan për të qënë)?

(Ако се бориш со жена) и (ја кутниш), (голема чест не ќе добиеш)

-ndërtime me më shumë pjesë

(Grues, në ia ngjitësh dorën) (kur të asht ngushtë), (ta jep shpirtin kur të asht shlrë)

(Ако се ожениш), (арно ќе сториш), (ама гледај) (дали ќе можеш жената да ја раниш)

Fjalitë e thjeshta njëkryegjymtyrëshe janë të përfaqësuara edhe në proverbat shqipe edhe në ato maqedonase:

Nënë e bi, - arkë e dry

Без жена, без кука

Fjalitë e shumta asindetike shprehin raporte nga më të ndryshmet, kurse nga hipotaksa si më interesante do t'i veçonim raportet me bashkërenditje, në kuadër të të cilave përkrah atyre tipike, paraqiten edhe të tilla me nuanca kohore dhe me nuancën shkak-pasojë. Nga fjalitë e përbëra me nënrenditje, fjalitë kohore, për shkak të natyrës përgjithësuese të proverbave, mund të kuptohen si fjali të përbëra kushtore me vlerë përgjithësimi, por mund të kenë edhe interpretim të kundërvënive. Ndërkaq në kudër të fjalive kushtore, nga ndarja e mundshme në fjali të kushtit real dhe joreal, në rastin tonë zbatim kanë gjetur fjalitë e interpretimit real. Proverbat për gruan realizohen edhe me fjali përcaktore dhe kryefjalore.

Një nga komponentët më të spikatur të proverbave është natyra e tyre gnomike. Me një status të këtille ato mund të aktualizohen, përdoren në shumë situata kontekstuale. Nga **kategoritë gramatikore** që e mundësojnë këtë karakteristikë të tyre, në plan të parë do të kishim veçuar **përgjithësimin** dhe **gjithëkohësinë** (në krijimin e universalitetit) dhe **mënyrën** dhe **vetën** (në krijimin e kornizës së kontaktit të afërt).

Duke e kryer funksionin e kryefjalës, e që përputhet me subjektin logjik, mjeti gjuhësor me të cilin shprehet kryefjala në proverbave ka vlerë kolektive. Zakonisht numri njëjës përveç referencës ndaj individit implikon edhe referencë ndaj kolektivit.

Kur flasim për kohën e tashme të përdorur në proverba, mendojmë për *prezentin gnomik*, përkatësisht për veprim që nuk ngujohet në asnjë kohë ose për veprim që mund të kryhet në çdo kohë dhe që sipas rrethanave edhe kryhet me të vërtetë. E tashmja e këtille shënon veprim që kryhet kurdo që jepet mundësia: në të kryerën, në të tashmen dhe në të ardhmen. Kohës së pakryer i përgjigjet semantika *kështu ka qenë gjithnjë dhe kështu do të jetë gjithnjë*, ndërsa të kryerës së thjeshtë *ndodhi një herë dhe mund të ndodhë edhe një herë tjetër*⁶. Përdorimi i një pjese të kohëve të shkuara është me funksion të përforcimit të vërtetësisë së pohimit: ajo që është e largët nuk mund të provohet dhe kështu as të kontestohet.

Në analizën tonë si kategori të rëndësishme gramatikore e veçojmë *mënyrën urdhërore*. Si në pragmatikë edhe këtu e dallojmë urdhrin e vërtetë nga rasti ku forma e mënyrës urdhërore nuk është urdhër i vërtetë, si dhe rastet ku imperativi është i motivuar, përkatësisht ku mund të vijojë motivimi. Meqë optativi formal (në raport me maqedonishten) është karakteristikë vetëm për gjuhën shqipe, atë e hasim vetëm në shembujt shqip. Në dy korpuset është interesant kombinimi i mënyrës urdhërore me thirrurin.

Veta është në korrelacion me mënyrën. Veta e dytë njëjës përdoret me kuptim të përgjithësuar, kurse veta e parë haset rrallë dhe, edhe pse jep një nuancë intime, gjithashtu ka kuptim të përgjithësuar.

Në specifikën e gjuhës së këtyre proverbave bëjnë pjesë edhe disa fjale që janë eksponentë leksikorë të kuptimeve të ketegorizuara. Të tilla janë: lidhëza *dhe* që paraqet kombinim të mohimit dhe implikimit; në maqedonisht leksema *sekoj* paraqitet si eksponent i kuantifikatorit të madh dhe gjithashtu bart mohim dhe implikim, kurse në gjuhën shqipe në këtë funksion na del përemri i pacaktuar *kush*; *emrat ë përveçëm* që më shpesh hasen te proverbat maqedonase ku ndonjëherë edhe vetë emri është bartës i mesazhit; fjala *Gospod (Zot)* gjithashtu është karakteristikë e proverbave maqedonase dhe përdoret për të arsyetuar pohimin, gjykimin apo kërcënimin nga pozita e autoritetit; orientalizmat dhe dialektizmat.

Kuptimi i thellë i proverbave shqipe dhe maqedonase për gruan shpreh **raporte specifike**. Në qoftë se formën – strukturën sipërfaqësore e interpretojmë më thellë, në qoftë se duam të kuptojmë çfarë krejt thuhet me të, qoftë edhe në mënyrë implicite, do të përfundojmë se ajo (forma), në një shtresë të thellë të strukturës përmban edhe diçka tjetër – kuptim të thellë. Lloji i njëjtë i mesazhit mund të thuhet me model të ndryshëm sintaksor.

4. PËRFUNDIMI

Numri i proverbave është shumë më i madh se ai i mesazheve të tyre, të cilat përsëriten. Analiza tregoi se proverbat shqipe dhe maqedonase për gruan bartin lloji të njëjtë të mesazheve, të cilat në të dyja rastet realizohen me struktura të ndryshme formale. Edhe proverbat shqipe edhe ato maqedonase, realizohen me skema sintaksore pothuaj të njëjta.

⁶ Топољинска З. Спасов А. Спасов. Љ. *Опис и класификација на поговорките како автономен семиотичен и јазичен микросистем* – МАНУ – Скопје, 1986, 59-60

BIBLIOGRAFIA

- Bugarski, R. (1989). Uvod u lingvistiku. Zavod za udzbenike i nastavna sredstva. Beograd.
- Dançetoviq, V. (1971). Fjalë të urta shqipe. Rilindja. Prishtinë.
- Dibra, M. (2016). Studime për estetikën e folklorit. QSA. Tiranë.
- Ibrahimi, Z. (2014). Interlinearis: studime mbi gjuhë shqipe. ITSHKSH. Shkup.
- Mangelli, S. (2015). Çështje të semiologjisë dhe semantikës në planin krahasues midis shqipes dhe anglishtes. Marrë nga [www.doktoratura.unitir.edu.al > wp-content > uploads > 2015/10 > Doktor...](http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/10/Doktor...)
- Taylor, A. (1931). The proverb. Cambridge.
- Thomaj, J. & Lloshi, Xh. (1967). Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit. Tiranë.
- Николиновска, Д. (2015). „Доброто” и „лошото” како вредносни категории во пословиците во италијанскиот, во јапонскиот и во македонскиот јазик. Скопје.
- Панзова, В. (1996). Универзалната граматика и македонскиот јазик. Епоха. Скопје.
- Ќулафкова, К. (2016). Балкански идентитети. Прилози од научноистражувачкиот проект „Културната интеграција и стабилноста на Балканот. МАНУ. Скопје
- Тополињска З. Спасов А. & Спасов. Љ. (1986). Опис и класификација на поговорките како автономен семиотичен и јазичен микросистем. МАНУ. Скопје. 1986
- Цепенков, М. (1972). Македонски народни умотворби (книга VIII) Пословици, поговорки, гатанки, клетви, благослови. Македонска книга. Скопје.